



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

AA.nr.118/2025

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Delushe Halimi, kryetare, Milena Đerić dhe Faton Ademi anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga Labinot Halilaj, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Komunën e Glllogocit, nga subjekti politik: Për Drenasin Kampion me Ramiz Lladrovcin (PDKRLL), kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankese dhe Parashtresa (PZAP), ZL. Anr.410/2025, të datës 07.11.2025, për shpalljen e rezultateve përfundimtare për anëtarë të Kuvendit Komunal, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, të mbajtura më datë 12 tetor 2025, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 14.11.2025, merr këtë:

AKTGJYKIM

Refuzohet e pathemeltë ankesa e parashtruar nga ankuesi: Labinot Halilaj, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Komunën e Glllogocit, nga subjekti politik: Për Drenasin Kampion me Ramiz Lladrovcin (PDKRLL), kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankese dhe Parashtresa (PZAP), ZL. Anr.410/2025, të datës 07.11.2025.

Arsyetim

Me vendimin e Panelit Zgjedhor për Ankese dhe Parashtresa (PZAP), ZL. Anr.410/2025, të datës 07.11.2025, është vendosur: Hedhet e palejuar ankesa e parashtruar nga kandidati për anëtar të Kuvendit Komunal në Komunën e Glllogocit, nga subjekti politik: Për Drenasin Kampion me Ramiz Lladrovcin (PDKRLL), Labinot Halilaj, ZLAnr.410/2025, e datës 05.11.2025, të paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, Nr.01/3093-2025, të datës 03.11.2025, për shpalljen e rezultateve përfundimtare për anëtarë të Kuvendit Komunal për Zgjedhjet Lokale të datës 12 Tetor 2025.



Me aktvendimin ZL. Anr. 410-2/2025, të datës 09.11.2025, në pikën I. Korrigjohet vendimi i PZAP-it, ZL. Anr. 410/2025, i datës 07.11.2025, ku në faqen e parë të dispozitivit të vendimit të PZAP-it, pika I, e paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me seli në Prishtinë, Nr. 01/3093-2025, të datës 03.11.2025, për shpalljen e rezultateve përfundimtare për anëtarë të kuvendit komunal për Zgjedhjet Lokale të datës 12 tetor 2025, duhej të ishte paraqitur kundër Shpalljes së Rezultateve Përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale në Republikën e Kosovës për Kuvendin Komunal Glllogoc dhe parregullsive gjatë procesit zgjedhor, për shpalljen e rezultateve përfundimtare për anëtarë të kuvendit komunal për Zgjedhjet Lokale të datës 12 tetor 2025, ndërsa në pikën II. Pjesa tjetër e vendimit mbetet e pandryshuar.

Kundër këtij vendimi ankesë në Gjykatën Supreme, ka parashtruar Labinot Halilaj, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Komunën e Glllogocit, nga subjekti politik: Për Drenasin Kampion me Ramiz Lladrovcin (PDKRLL), me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij, për shkak të: shkeljes së dispozitave të LZP-së, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe shkeljes të së drejtës materiale, duke i propozuar gjykatës që të: aprovoj të bazuar ankesën e ankuesit dhe të prish vendimin e PZAP-it, ZL. Anr.410/2025, e datës 07.11.2025, dhe të urdhëroj verifikimin dhe rinumërimin e të gjitha kutive të votimit në Komunën e Glllogocit.

PZAP, në përgjigje në ankesën e paraqitur kundër vendimit të atakuar, i konteston në tërësi thëniet ankimore dhe propozon që ankesa e parashtruar nga Labinot Halilaj, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Komunën e Glllogocit, nga subjekti politik: Për Drenasin Kampion me Ramiz Lladrovcin (PDKRLL), të refuzohet si e pabazuar, ndërsa vendimi i kontestuar i PZAP-it, ZL. Anr.410/2025, e datës 07.11.2025, të vërtetohet.

Gjykata Supreme e Kosovës, e vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar, në kuptim të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesa është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se më datë 05.11.2025, PZAP-i ka pranuar ankesën ZL.Anr.410/2025, të parashtruar nga kandidati për anëtar të Kuvendit Komunal në Komunën e Glllogocit, nga subjekti politik: Për Drenasin Kampion me Ramiz Lladrovcin (PDKRLL) Labinot Halilaj, me të cilën pretendon se duhet të ketë hetim dhe rinumërim të tërësisht të



votave për shkak të parregullsive të shumta të evidentuara gjatë dhe pas procesit të votimit dhe numërimit në Komunën e Glllogocit, të cilat kanë rezultuar me vendime të padrejta dhe të cilat bien ndesh me vullnetin e votuesve dhe cenojnë rëndë demokracinë, të drejtën e votës, e cila është e drejtë fundamentale, e garantuar me Kushtetutën tonë dhe me të gjitha konventat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Në ankesë ka theksuar se: pas krahasimit të formularëve zyrtarë të vendvotimeve me ata të QNK, ishte konstatuar mospërputhje e dukshme në pikën 10 të formularëve, që lidhet me votat e paplotësuara dhe ato të pavlefshme. Qendrat e vendvotimeve si në vijim: 0301/01 Glllogoc - 10 vota, SH.F.M.U. "Rasim Kiçina"; 0301/01 Glllogoc - 10 vota, SH.F.M.U. "Rasim Kiçina"; 0315/01 Dobroshec - 4 vota, SH.F.M.U. "Rilindja"; 0307/01 Zabel i Ulët - 6 vota, SH.F.M.U. "Arfi Shala"; 0311/02 Tërstenik I - 2 vota, SH.F.M.U. "Zenel Hajdini"; 0301/04 Glllogoc - 10 vota, SH.F.M.U. "Rasim Kiçina"; 0307/01 Zabel i Ulët - 6 vota, SH.F.M.U. "Arif Shala"; 0312/02 Tërstenik II - 1 votë, SH.F.M.U. "Dëshmorët e Qëndresës II"; 0316/02 Glllanasellë - 0 vota, SH.F.M.U. "Xhevë Lladrovci"; 0304/02 Poklek i Ri - 3 vota, SH.F.M.U. "Fehmi Lladrovci"; 0314/02 Vërboc - 3 vota, SH.F.M.U. "Dëshmorët e Fshatit"; 0324/01 Arllat - 0 vota, SH.F.M.U. "Abedin Bujupi"; 0318/02 Tërdec - 19 vota, SH.F.M.U. "Shote Galica"; 0310/02 Komoran - 0 vota, SH.F.M.U. "Xheladin Gashi - Plaku"; 0320/01 Shtuticë - 0 vota, SH.F.M.U. "Azem Bejta"; 0317/04 Llapushnik - 3 vota, SH.F.M.U. "Hasan Prishtina"; 0317/03 Tërstenik II - 9 vota, SH.F.M.U. "Dëshmorët e Qëndresës II"; 0310/03 Komoran - 1 votë, SH.F.M.U. "Xheladin Gashi - Plaku"; 0304/01 Poklek i Ri - 4 vota, SH.F.M.U. "Fehmi Lladrovci"; 0303/01 Cikatovë e Re - 3 vota, SH.F.M.U. "Ali Gashi"; 0325/01 Fushticë e Poshtme - 6 vota, SH.F.M.U. "24 Korriku"; 0327/01 Korroticë e Epërme - 0 vota, SH.F.M.U. "Shaban Polluzha"; 0329/02 Nekoc - 0 vota, SH.F.M.U. "Bajram Curri"; 0329/03 Nekoc - 0 vota, SH.F.M.U. "Bajram Curri"; 0301/02 Glllogoc - 2 vota, SH.F.M.U. "Rasim Kiçina"; 0315/02 Dobroshec - 5 vota, SH.F.M.U. "Rilindja"; 0302/03 Glllogoc - 6 vota, SH.F.M.U. "Halil Bajraktari".

Faktet e lartcekura ngritin dyshim të bazuar se votat e raportuara si të paplotësuara në vendvotime mund të jenë plotësuar më pas në QNK në favor të ndonjë kandidati preferencial për Kuvend Komunal, ndërsa numri i votave të pavlefshme ishte rritur në mënyrë të pashpjegueshme, gjë që kishte ndikuar negativisht në rezultatin për kandidat të caktuar. Ankuesi në ankesë deklaroi se kishte mospërputhje të formularëve zyrtarë të vendvotimeve dhe atyre në QNK, ku sipas tij kishte vërejtur mungesë të nënshkrimeve të një ose më shumë



anëtarëve të tavolinave të numërimit; konstaton se kishte mungesë të nënshkrimeve në formularët zyrtarë të numërimit, gjë që përbën shkelje të drejtpërdrejtë të rregullave të KQZ-së për dokumentimin dhe vlefshmërinë e formularëve të rezultateve. Gjatë procesit kishte vërejtur dyshime të bazuara se disa nga anëtarët prezent në QNK, pasi kishin vërejtur mospërputhje apo dallime në përmbajtjen e formularit, nuk kishin pranuar të nënshkruajnë fletën përfundimtare për t'i shpëtuar përgjegjësisë ligjore. Më tutje deklaroi se në disa vendvotime KQZ-ja kishte urdhëruar rinumërim për shkak të parregullsive të konstatuara, ndërsa rezultatet e rinumëruara kishin ndryshuar ndjeshëm. Shembull konkret ishte rinumërimi i vendvotimit 0305/02 në Glllogoc, përfshirë listën "Për Drenasin Kampion me Ramiz Lladrovcin", ku rreth 30 anëtarë të listës së votuesve janë rinumëruar. Nga ato, në 26 raste ishin vërejtur ndryshime të rezultateve midis numërimit fillestar në QNK dhe numërimit të rinumëruar në QNR. Ky fakt tregon qartë mospërputhjet që ishin të shtrira dhe nuk mund të kufizoheshin vetëm në vendvotimet ku ishte kryer rinumërimi.

Prandaj kërkon nga PZAP-i të urdhërojë verifikimin dhe rinumërimin e të gjitha kutive të votimit në Komunën e Glllogocit, me praninë e kandidatëve, të verifikojë përputhshmërinë e formularëve përfundimtarë me fletëvotimet origjinale, të sigurojë mbrojtjen e të drejtës së votuesve dhe kandidatit për transparencë të plotë në proces, të ndërmarrë masa sipas ligjit ndaj çdo personi apo komisioni që ka cenuar integritetin e procesit.

Në përgjigjen në ankesë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), theksohon se: Bazuar në nenin 101 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), Rregulloren Zgjedhore Nr. 16/2024, Qendrat Komunale të Numërimit (QKN), Procedura e Veprimit në Qendrën Komunale të Numërimit për Zgjedhjet Lokale 2025, e miratuar më 01.10.2025, Nr. 01/2601/2025, përcaktohet procedura e detajuar lidhur me procesin e numërimit në QKN. Rezultatet preliminare nga vendvotimet mund të korrigjohen në Qendrën Komunale të Numërimit në përputhje me paragrafin 3 të nenit 14 të Rregullores Zgjedhore Nr. 16/2024 për Qendrat Komunale të Numërimit (QKN). Andaj, bazuar në Rregullën Zgjedhore Nr. 13/2024 "Rezultatet Zgjedhore", neni 9 paragrafi 1 thekson se: Në rast të mospërputhjes së rezultateve, KQZ-ja mund të urdhërojë rinumërimin e votave të cilitdo vendvotimi, ose edhe përsëritjen e votimit në një vendvotim apo qendër votimi. Në përputhje me nenin e lartcekur, KQZ me datën 24.10.2025 ka marrë vendimin me nr. të protokollit 01/3006/2025 për Miratimin e Rekomandimit pas Procesit të Rinumërimit në QNR, ku ndër vendvotimet e rinumëruara kanë qenë edhe vendvotimet 0305/02 dhe 0329/02 në komunën e Glllogocit. Pas rinumërimit ka



rezultuar se: në vendvotimin 0305/02 mospërputhja e rezultateve pas rinumërimit nuk ka ekzistuar; në vendvotimin 0327/01 është rritur në tolerancën +/-1, në mënyrë që vendvotimi të procedohet si i rregullt; ndërsa në vendvotimin 0329/02 pas rinumërimit të kutisë, tek fletëvotimet e pavlefshme është gjetur një fletëvotim më pak sesa numri i shënuar në QKN dhe kështu më nuk ekziston diferenca.

Gjithashtu lidhur me pretendimet që pala ka ngritur lidhur me administrimin e punës në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN), sipas nenit 105 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ankesat që kanë të bëjnë me administrimin e numërimit në QKN dhe QNR dorëzohen me shkrim pranë PZAP-it brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i ndodhjes së shkeljes së supozuar. Andaj, KQZ ju njofton se procesi i numërimit dhe administrimit të punës së QKN-së në komunën e Glllogocit ka përfunduar me datë 18.10.2025. Në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, pala ankuese nuk ka ofruar dëshmi lidhur me parregullsitë në numërimin e votave që i përkasin kandidatëve për kuvendet komunale dhe me asnjë provë konkrete nuk ka mundur të konstatojë se ka pasur manipulim të votave, rrjedhimisht pritjet e ankuesit për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka pasur parregullsi dhe mungesë të votave. Pra nuk ka bashkangjitur libër të votimit në vendvotim dhe QKN, formularë ose prova të tjera që do të mund të mbështesnin pretendimet e saj. KQZ ju njofton se i gjithë materiali zgjedhor (duke përfshirë kamerat e sigurisë, librat e votimit dhe formularët) gjenden në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve - QNR dhe të njëjtat mund të verifikohen dhe hetohen nga PZAP dhe organet e drejtësisë.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, me vendimin ZL. Anr.410/2025, e datës 07.11.2025, ka refuzuar të pabazuar ankesën e parashtruar nga Labinot Halilaj, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Komunën e Glllogocit, nga subjekti politik: Për Drenasin Kampion me Ramiz Lladrovcin (PDKRLL).

PZAP, në arsyetim të vendimit të tij ndër të tjera ka theksuar se: Paneli vlerëson se pretendimet e palës ankuese, edhe pse i referohen parregullsive dhe kërkesës për rinumërim të tërësishëm të votave për shkak të parregullsive të shumta të evidentuara gjatë dhe pas procesit të votimit dhe numërimit në Komunën e Glllogocit, përmes ankesës atakohet rezultati i votimit/rinumërimit, e kanë të bëjnë me numërimin/rinumërimin e votave në disa vendvotime të cilat janë rinumëruar nga KQZ. Ndërsa sipas Vendimit 01/3243-2025, të datës 05.11.2025,



në ora 15:00, për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale në Republikën e Kosovës për Kuvendin Komunal në Glllogoc, të mbajtura më 12 tetor 2025, janë shpallur rezultatet përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Komunën e Glllogocit.

Nga shkresat e lëndës, përkatësisht provave të bashkangjitura me përgjigje në ankesë, PZAP ka gjetur se KQZ-ja në mbledhjen e mbajtur me datë 05.11.2025 në ora 15:00, mori vendim nr. 01/3243-2025 dt. 05.11.2025 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve për Kuvendin Komunal të Komunës së Glllogocit. Në bazë të këtij vendimi të KQZ-së nr. 01/3243-2025, të datës 05.11.2025, subjektet politike të certifikuara dhe kandidatët mund të paraqesin ankesat e tyre ndaj këtyre rezultateve në afat brenda 48 orësh në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës, nga shpallja e rezultateve, duke filluar nga data 05.11.2025 në ora 15:00. Në këtë rast nga shkresat e lëndës konstatohet se ankesa në PZAP ka arritur me datë 05.11.2025 në ora 14:42, ndërsa sipas Vendimit nr. 01/3243-2025, afati për paraqitjen e ankesës fillon të llogaritet nga data 05.11.2025 ora 15:00, e që rrjedhimisht rezulton se ankesa është e parakohshme, prandaj PZAP vendosi se ankesa e ankuesit është e palejuar. Pretendimet e tjera të parashtruesit të ankesës PZAP nuk i ka shqyrtuar, sepse fillimisht ankesa ekzaminohet në drejtim të lejueshmërisë dhe afatshmërisë dhe nëse rezulton se është e palejueshme apo jashtë afatit, paneli e hedh poshtë pa u lëshuar në përmbajtje të ankesave dhe pretendimeve ankimore sikurse në rastin konkret. Të gjitha deklaratimet dhe pretendimet e subjektit ankues, edhe sikur të qëndronin apo të merreshin të mirëqena, nuk mund të shqyrtohen dhe ekzaminohen në këtë fazë, pasi aspekti i lejueshmërisë është veprim paraprak i cili nuk ka mundësi të anashkalohet. Neni 106 paragrafi 3 i Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës parasheh se personi fizik ose juridik, të drejtat ligjore të të cilit janë cenuar me vendimin e KQZ-së, sa i përket shpalljes së rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve, mund të parashtrojë ankesë në PZAP brenda dyzet e tetë (48) orëve nga shpallja e tij.

Ka shtuar se: Neni 115 i LZP-së parasheh se PZAP është organ i përhershëm i pavarur kompetent për të vendosur në lidhje me ankesat e lejuara që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor sipas këtij ligji dhe rregullave zgjedhore. Neni 13 i Rregullores Nr. 01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it përcakton se: "PZAP-i e hedh ankesën kur vlerëson se ajo nuk plotëson kërkesat e LZP-së dhe kësaj rregulloreje për shqyrtim". Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore, PZAP erdhi në përfundim se ankesa është e palejueshme, për arsye se dispozitat e cituara i referohen lejueshmërisë së ankesës të kushtëzuar, përveç tjerash, edhe me afatin për paraqitjen e saj, i cili është dyzet e tetë (48) orë.



nga shpallja e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve. Ndërsa lidhur me pretendimet që pala ka ngritur lidhur me administrimin e punës në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN), sipas nenit 105 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ankesat që kanë të bëjnë me administrimin e numërimit në QKN dhe QNR dorëzohen me shkrim pranë PZAP-it brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i ndodhjes së shkeljes së supozuar. Andaj, edhe sa i përket këtyre pretendimeve vlerësohet se ankesa është jashtë afatit, për arsye se procesi i numërimit dhe administrimit të punës së QKN-së në komunën e Glllogocit ka përfunduar me datë 18.10.2025. Prandaj, nga arsyet e theksuara më lart, dhe në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së dhe nenit 13.3 të Rregullores Nr. 01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, paneli vendosi si në dispozitiv të vendimit të tij.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë faktike dhe ligjore e çështjes, e pranon në tërësi si të drejtë dhe të bazuar qëndrimin juridik të PZAP-it, si në vendimin e tij, me të cilin e ka hedhur poshtë të palejuar ankesën e ankuesit Labinot Halilaj, për shkak të shpalljes së rezultateve përfundimtare, për Zgjedhjet Lokale për Kuvendet Komunale, që janë mbajtur më datë 12 Tetor 2025. Vendimi i PZAP është i drejtë i kuptueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare nga vërtetohet se edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë në kuptim të dispozitave ligjore të Ligjit Nr. 03/L-072 Për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, si dhe të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, të cilat mutatis mutandis vlejné edhe për zgjedhjet lokale përveç nëse përcaktohet ndryshe me anë të këtij ligji.

Objekt shqyrtimi dhe vlerësimi në Gjykatën Supreme të Kosovës ishin pretendimet e ankuesit, Labinot Halilaj, përkitazi me numrin e votave të fituara në Zgjedhjet Lokale për Kuvendet Komunale, të mbajtura më 12 tetor 2025, në Komunën e Glllogocit, ku ndër të tjera theksi i pretendimeve të tij vihet në: pretendimin se gjatë procesit të votimit dhe të numërimit në Komunën e Drenasit janë konstatuar parregullsi të shumta, përfshirë ndërprerje të kamerave të sigurisë, ndërprerje të sistemit të futjes së të dhënave, mungesë të formularëve origjinalë për vëzhguesit, kufizim të qasjes në materialin zyrtar dhe mos-përputhje mes formularëve të vendvotimeve dhe atyre të Qendrës së Numërimit dhe Kontrollit (QNK).

Gjykata Supreme e Kosovës, pretendimet e lartcekura i shqyrtoj në tërësi në baza ligjore dhe i refuzoj në tërësi si të pathemelta, sepse të njëjtat nuk janë provuar dhe faktuar, si dhe nuk kanë mbështetje ligjore, andaj, si të tilla juridikisht janë të paqëndrueshme. PZAP, në përputhje me



dispozitat ligjore e ka shqyrtuar ankesën e paraqitur nga ankuesi në aspekt të lejueshmërisë dhe afatshmërisë së saj. Siç është e përcaktuar qartë në nenin 13 të Rregullores Nr. 01/2025, PZAP ka detyrën të shqyrtojë fillimisht lejueshmërinë e ankesës, duke u fokusuar në përmbushjen e kushteve ligjore, përfshirë afatet e caktuara për dorëzimin e ankesës. Në këtë rast, PZAP drejtë ka konstatuar se ankesa ishte e parakohshme, dhe si rrjedhojë ka vendosur që të hedhë poshtë ankesën pa u përfshirë në shqyrtimin e përmbajtjes së pretendimeve.

Sipas nenit 106 [Rezultatet zgjedhore] par.3 të Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ku përcaktohet se: *"3. Personi fizik ose juridik, të drejtat ligjore të të cilit janë cenuar me vendimin e KQZ-së, sa i përket shpalljes së rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve, mund të parashtrojë ankesë në PZAP, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga shpallja e tij. Ankesa vendoset nga PZAP brenda nëntëdhjetë e gjashtë (96) orëve, nga parashtrimi i saj."* si dhe neni 13 [Vendimmarrja e PZAP-it] të Rregullores nr. 01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, ku përcaktohet se: *"3. PZAP-i, e hedhë ankesën kur vlerëson se ajo nuk përmbush kërkesat e LQP-së dhe kësaj rregullore për shqyrtim. 3.2. nuk është dorëzuar në afatin e paraparë ligjor"*.

Në kuptim të dispozitave të lartcekura, është e qartë se çdo person, fizik ose juridik, mund të parashtrojë ankesë në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Padi (PZAP) brenda 48 orëve nga shpallja e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve, që nënkupton që çdo ankesë duhet të dorëzohet brenda afatit të përcaktuar me ligj. Ky është një afat i qartë ligjor që ka për qëllim të garantojë efikasitetin dhe rendin në procesin zgjedhor. Afati për dorëzimin e ankesës, siç përcaktohet nga KQZ-ja në vendimin nr. 01/3243-2025 të datës 05.11.2025, fillon të llogaritet nga ora 15:00 e datës 05.11.2025. Ndërsa nga shkresat e lëndës, shihet se ankesa e palës ankuese ka arritur në PZAP më datë 05.11.2025 në ora 14:42, pra para se të fillonte periudha ligjore për dorëzimin e ankesës.

Bazuar në dispozitat e më sipërme, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se, PZAP ka zbatuar drejtë ligjin sipas fakteve të vërtetuara duke e hedhur poshtë ankesën e palës ankuese si të palejuar sepse, ankesën e ushtruar pala ankuese e ka dorëzuar para afatit të përcaktuar ligjor, andaj si e tillë nuk i ka plotësuar kushtet ligjore për tu shqyrtuar dhe vendosur në mënyrë meritore, për shkak të metave procedurale. Prandaj vendimi i ankmuar, rezulton se është i qartë dhe i kuptueshëm, përmban arsye ligjore të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, e pa ashtu edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë në këtë çështje, andaj theksimet në ankesë kolegjii



vlërëson se nuk janë të qëndrueshme apo me ndikim për të vendosur ndryshe në këtë çështje nga ajo e vendosur nga PZAP si në vendimin e tij.

Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se vendimi i PZAP për të hedhur poshtë ankesën e ankuesit është i drejtë, i ligjshëm dhe i arsyetuar. PZAP ka zbatuar drejtë dispozitat ligjore duke hedhur poshtë ankesën e ankuesit për shkak të të metave procedurale pa kaluar në shqyrtimin e përmbajtjes së saj. Ndërsa, pretendimet tjera që ankuesi ka ngritur, edhe sikur të qëndronin si të vërteta, nuk mund të shqyrtoheshin nga PZAP pa u plotësuar kërkesat e afateve ligjore për dorëzimin e ankesës.

Nga theksimet si më lartë dhe në bazë të nenit 118 paragraf 4, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

AA.nr.118/2025, më datë 14 nëntor 2025

Kryetare e kolegjit,
Delushe Halimi



Republika e Kosovës
AKTËSINË E KOPJËS E VËRTETËN
AČNOST OTPRAVKA POTVRDIJE

Punëtori i autorizuar
Delašćeni ra...
[Signature]